

VENDIM
Nr. 459, datë 27.5.2015

**PËR MIRATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR HARTIMIN E POLITIKËS DHE MASAVE
PËR NJË MJEDIS MUNDËSUES PËR SHOQËRINË CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit, ministrit të Integritimit Evropian dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e udhërrëfyesit për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Kryeministria është përgjegjëse për bashkëveprimin dhe monitorimin për zbatimin e udhërrëfyesit.
 3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përmendura në shtojcën 1 për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËRRËFYESI
**PËR HARTIMIN E POLITIKËS DHE MASAVE PËR NJË MJEDIS MUNDËSUES PËR
SHOQËRINË CIVILE**

HYRJE

Shoqëria civile aktive dhe aktive është komponent kyç i demokracisë pluraliste. Bashkëpunimi dhe partneriteti ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile në formësimin dhe zbatimin e politikave publike janë veçori thelbësore të një shteti modern që është në shërbim të qytetarit. Forcimi i dialogut me qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHQ) në procesin e hartimit të politikave publike sjell një sërë dobish. I mundëson qeverisë të përftojë burime infor-macioni dhe ekspertizë të gjerë, gjë që përmirëson cilësinë e politikave të reja dhe ofrimin e shërbimeve publike, por edhe kontribuon në monitorimin dhe vlerësimin eficient të politikave ekzistuese, si edhe në përcaktimin e ndryshimeve të nevojshme.

Qeveria e ka bërë të qartë angazhimin e saj për krijimin e një mjedisi të shëndetshëm që inkurajon pavarësinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë civile, duke kontribuar në tejkalimin e hendekut mes qytetarëve dhe institucioneve. Për këtë qëllim, programi i qeverisë 2013-2017 thekson nevojën e reformave në lidhje me: i) përmirësimin e kuadrit ligjor dhe fiskal për veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse (OJF) që do të siguronte më shumë mbështetje për sektorin përmes filantropisë korporative dhe individuale dhe përfshirjes së vullnetarëve; ii) rritjen e transparencës së punës së institucioneve publike nëpërmjet publikimit të mundësive për bashkëpunim, si edhe të rregullave dhe procedurave për aplikim për financim publik të projekteve të organizatave jofitimprurëse; iii) konsultimin e gjerë të nismave të reja ligjore me shoqërinë civile, në mënyrë që të merret *feedback*-u dhe vlerësimi i OSHC-ve; dhe iv) forcimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për të ofruar shërbime të cilat shteti nuk është ende në gjendje t'i ofrojë.

Këto angazhime të qeverisë janë në përputhje me udhëzimet për mbështetjen nga Bashkimi Evropian i shoqërisë civile në vendet e zgjerimit për periudhën 2014-2020, të hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit e Komisionit Evropian me qëllimin për të garantuar një kuadër solid për matjen e procesit në zhvillimin e një demokracie dinamike, stimuluese dhe pjesëmarrëse në vendet që synojnë aderimin në BE. Udhëzimet fokusohen në një numër objektivash, rezultatesh dhe indikatorësh që vlerësojnë performancën e vendeve në krijimin e një mjedisi të favorshëm për veprimtarinë e shoqërisë civile dhe në konsolidimin e kapaciteteve të OSHC-ve për të qenë aktorë të pavarur efektivë dhe llogaridhënës.

Aktualisht, për vitin 2014, nga të dhënat zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, numri i organizatave jofitimprurëse aktive rezulton 2427, ndërsa të punësuarit në sektorin e OJF-ve rezulton të jetë 7505. Shumica e OSHC-ve janë të përqendruara në Shqipërinë qendrore, sidomos në Tiranë. Organizatat e tjera janë të përhapura kryesisht në Veri (Shkodër) dhe në Jug (Korçë, Fier dhe Vlorë). Sektori i shoqërisë civile në zonat e largëta dhe sidomos në zonat rurale vazhdon të jetë shumë i dobët. Edhe numri i grupeve informale aktive me bazë komunitare është relativisht i ulët.

Progres-raporti 2014 i Komisioni Evropian shprehet se sektori i shoqërisë civile në Shqipëri mbetet i copëzuar dhe tejet i varur nga financimet e donatorëve. Komisioni konstatoi përmirësimet në bashkëpunimin ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile. Është e vërtetë që shoqëria civile është konsultuar rregullisht mbi nismat e politikave dhe ato ligjore, por konsultimet me

OSHC-të duhet të bëhen më sistematike dhe transparente, përfshi këtu edhe reflektimin e rekomandimeve që ato japin. Gjithashtu, komisionet parlamentare kanë qenë proaktive në mbajtjen e konsultimeve me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, por vazhdon problematika e njoftimeve në momentin e fundit dhe mungesa e rregullave të qarta mbi konsultimet publike. Po kështu, bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore mbetet shumë i dobët, për shkak se mungojnë kapacitetet adekuate që garantojnë bashkëpunimin dhe financimin e duhur për OSHC-të.

Vlerësimi i Reformës në Administratën Publike të kryer nga SIGNMA në 2014-ën thekson se qeveria ka ndërmarrë ndryshime për të eliminuar mangësitë në procesin e planifikimit dhe të monitorimit, si edhe ka forcuar angazhimin me shoqërinë civile. Në përgjithësi, SIGMA vlerëson përfshirjen e ministrave dhe të nëpunësve civilë të rangut të lartë në nismat konsultuese, por njih nevojën për bazë ligjore më të qartë dhe më të saktë për procedurat e konsultimit.

Raporti 2014 për Shqipërinë "Matrica monitoruese mbi mjedisin mundësues për zhvillim të shoqërisë civile" thekson se legjislacioni fiskal mbetet sfida kryesore për OSHC-të, pasi krijon barrierë administrative të panevojshme ndaj veprimtarisë së OSHC-ve dhe pengon rolin e tyre në ofrimin e shërbimeve sociale. I njëjti raport sjell vëmendjen në mungesën e një dokumenti strategjik kombëtar kushtuar zhvillimit të shoqërisë civile, mungesën e strukturave institucionale adekuate dhe të mekanizmave lehtësues për marrëdhëniet shtet-OSHC; në veçanti, thekson mungesën e rregullave dhe të procedurave të qarta (dhe të kapaciteteve brenda organeve shtetërore) për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm.

Gjatë vitit të fundit, Kryeministria ka punuar me OSHC-të për të kuptuar nevojat kyçe dhe trendet e fundit në mbështetjen e zhvillimit të shoqërisë civile, veprimtaritë e mundshme që mund të zhvillohen në vitet në vijim, si edhe barrierat që duhen kapërcyer për të mundësuar zbatimin me sukses dhe kosto-efektiv të reformave kryesore.

Nevojitet një përqaasje më e strukturuar për të krijuar një mjedis favorizues për zhvillimin e shoqërisë civile, sepse vetëm kështu sigurohet progres i qëndrueshëm në zbatimin e angazhimeve të qeverisë dhe adresohen thirrjet e shoqërisë civile për reforma më thelbësore, si edhe përmbushen kërkesat e aderimit në BE.

Ky udhërrëfyes paraqet një program me fusha prioritare veprimi ku qeveria po merr masa për të përmirësuar mjedisin e bashkëpunimit me shoqërinë civile. Dokumenti identifikon fusha të mundshme të tjera ku mund të ketë nevojë për asistencë teknike në të ardhmen. Pritet që ky dokument të kontribuojë në zhbllokimin e potencialit që mbruhet nga përmirësimi i bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile, si një parakusht për zbatim të qëndrueshëm dhe të pakthyeshëm të reformave të ndërmarra në kuadrin e procesit të anëtarësimit në BE.

FUSHAT PRIORITARE TË VEPRIMIT

Udhërrëfyesi fokusohet në nëntë fusha prioritare të identifikuara përmes takimeve të hapura konsultative me OSHC-të dhe diskutimeve mes përfaqësuesve të qeverisë dhe donatorëve gjatë muajit korrik 2014, si edhe bazuar në analizën e raporteve, studimeve dhe vlerësimeve të sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri. Më konkretisht, nëntë fushat prioritare mishërojnë parimet dhe objektivat e përcaktuara në udhëzimet mbi mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile 2014-2020, të cilat janë konceptuar si kuadër për vendet aspirante si një rajon më vite dhe shtrojnë themelet për një përqaasje në nivel kombëtar sipas kontekstit të vendit. Këto udhëzime mundësojnë matjen e procesit të secilit vend, si edhe të rajonit të vendeve aspirante.

Fushat prioritare:

1. Mjedisi kombëtar i politikave strategjike për zhvillimin e shoqërisë civile
2. Institucionet që mbështetin bashkëpunimin qeveri-OSHC
3. Përfshirja e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes
4. Kuadri i financimit publik për programet e OSHC-ve
5. Kuadri legjislativ për regjistrimin dhe punën e OSHC-ve
6. Raportimi/kontabiliteti financiar dhe trajtimi tatimor i OSHC-ve
7. Mbledhja e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile
8. Zhvillimi i vullnetarizmit
9. Kontributi i OSHC-ve në procesin e integritetit evropian të Shqipërisë.

Për çdo fushë prioritare, prezantohet analiza bazë dhe argumentimi, bashkë me një grup masash të propozuara për reformën. Masat janë numërtuar për ta bërë më të lehtë monitorimin dhe rishikimin e tyre. Përveç kësaj, janë identifikuar disa fusha të mundshme për asistencë teknike në të ardhmen, me fokus ngritjen e kapaciteteve të organeve të pushtetit për të zbatuar reforma të vështira që mundësojnë një mjedis më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile.

1. MJEDISI KOMBËTAR I POLITIKAVE STRATEGJIKE PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË

CIVILE

Për krijimin e një mjedisi më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile, qeveria duhet të marrë masa konkrete në fusha me ndërlidhje dhe komplementaritet mes tyre (kuadri ligjor dhe institucional për punën e OSHC-ve, financimi publik për programet e OSHC-ve, standardet e ofrimit të shërbimeve sociale, konsultimet mes OSHC-ve në hartimin e ligjeve të reja, vullnetarizmi, filantropi, politika tatimore për OSHC-të etj.). Projektstrategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim konsideron shoqërinë civile si sektor që kërkon formulimin e objektivave të qartë dhe marrjen e aksioneve nga qeveria deri në 2020-ën. Edhe pse janë bërë përmirësime të vyera vitet e fundit, qeveria duhet të tregojë koherencë më të madhe në adresimin e sfidave të shumta në fushën komplekse të zhvillimit të shoqërisë civile si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë vendor.

Për të siguruar angazhim afatgjatë dhe përqasje sistematike të qeverisë në zbatimin e reformave të nevojshme, si dhe krijimin e platformës për konsensus me OSHC-të dhe aktorët e tjerë për të gjitha masat e nevojshme, Këshilli i Ministrave duhet të konsiderojë mundësinë e miratimit të një strategjie për krijimin e mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri, si edhe të planit të veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, me indikatorë specifikë dhe të matshëm, shoqëruar me vlerësim preciz të efekteve financiare të të gjitha veprimtarive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e koordinimit të politikave në këtë fushë shumë komplekse, ku përfshihen aktivitetet e një sërë ministrish dhe agjencish shtetërore. Strategjia dhe plani i veprimit duhet të hartohen në bashkëpunim të ngushtë me OSHC-të, përmes një procesi pjesëmarrës dhe përfshirës. Ky dokument do të jetë bazë solide për programimin e buxhetit të shtetit dhe fondeve të BE-së për sektorin e shoqërisë civile, si edhe mund të forcojë zotërimin vendor të reformave në këtë fushë të rëndësishme.

Aksione të propozuara:

1.1 Përgatitja e Strategjisë Kombëtare për krijimin e mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri deri në 2020-ën, si edhe i planit të veprimit për zbatimin e strategjisë, me indikatorë të matshëm, me vlerësim konkret efektesh financiare dhe me procedurë të qartë raportimi, monitorimi dhe vlerësimi për të gjitha masat;

1.2 Mundësimi i pjesëmarrjes së OSHC-ve në të gjitha fazat e përgatitjes së strategjisë dhe planit të veprimit, si edhe zhvillimi i një procesi konsultimi gjithëpërfshirës dhe të plotë me palët e interesuara për draftin e Strategjisë Kombëtare dhe planit të veprimit;

1.3 Përgatitja e raportit mbi rezultatet e konsultimeve publike për draftin e Strategjisë/planit kombëtar dhe qarkullimi i gjerë i tij, para dërgimit të draftit për procedurë miratimi;

1.4 Ngritja, pas miratimit të Strategjisë dhe të planit të veprimit, e një sistemi të hapur dhe transparent për gjurmimin e progresit të bërë në zbatimin e të gjitha masave përmes një portali *web*, ku hidhet i gjithë informacioni i përditësuar mbi zbatimin e Strategjisë dhe të planit të veprimit;

1.5 Kryerja e vlerësimit të jashtëm të zbatimit të planit të veprimit.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Asistimi i qeverisë në realizimin e procesit të hapur dhe pjesëmarrës të hartimit të Strategjisë Kombëtare dhe planit të veprimit, përfshi organizimin e diskutimeve rajonale dhe lehtësimin e *workshop*-eve tematike për të gjitha nënfushat e Strategjisë Kombëtare, si edhe përgatitjen e raportit mbi rezultatet e konsultimeve publike;

- Mbështetja e organizimit të seminareve trajnuese për organet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e masave të planit të veprimit;

- Asistimi i qeverisë në ngritjen e një sistemi solid raportimi, monitorimi dhe vlerësimi në lidhje me zbatimin e planit të veprimit, përfshi ngritjen e një portali *web* dhe instrumenteve të tjera për informimin dhe komunikimin;

- Zhvillimi i fushatave sensibilizuese ndër qytetarët dhe OSHC-të mbi objektivat dhe masat e prioriteteve të strategjisë.

Institucionet përgjegjëse: KM, MIE, AMSHC

2. Institucionet që mbështetin bashkëpunimin qeveri-OSHC

Krijimi i mjedisit favorizues për bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile nënkupton ngritjen e mekanizmave dhe strukturave institucionale cilësore, si edhe konsolidimin e kapaciteteve për realizimin efektiv të detyrave kyçe, konkretisht:

- Dialog i strukturuar ndër organet shtetërore relevante dhe përfaqësuesve të OSHC-ve mbi të gjitha politikat që prekin shoqërinë civile;

- Financim publik të qëndrueshëm për programet e OSHC-ve dhe përgatitjen e partneriteteve strategjike me OSHC-të që synojnë dhënien e shërbimeve sociale me interes të përgjithshëm;

- Koordinim qendror solid i zhvillimit dhe zbatimit të politikave të qeverisë për shoqërinë civile, përfshi

mbështetjen për programin strategjik eficient të mbështetjes shtetërore për OSHC-të;

- Mbështetja e përfshirjes së qenësishme / kuptimplote të OSHC-ve në procesin e politikëbërjes në të gjithë sektorët.

Për të realizuar detyrat dhe konsolidimin e përpjekjeve të mëparshme në këtë fushë, nevojitet rishikim dhe përmirësim i arkitekturës institucionale që mbështet shoqërinë civile, e cila mund të mbështetet në këta mekanizma institucionalë:

- Këshilli Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile;
- Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC);
- Njësia e Koordinimit të Politikave të Shoqërisë Civile në Kryeministri;
- Njësitë/personat e kontaktit për bashkëpunimin me OSHC-të në ministritë/organet publike përkatëse.

Më poshtë përshkruhet secili mekanizëm institucional me informacion bazë mbi potencialin, vizionin, misionin dhe objektivat, lidhjet institucionale me strukturat e tjera të propozuara, si edhe masat kyçe që duhet të çojnë në përmbushjen e objektivave, shoqëruar me fushat e mundshme për asistencë teknike në të ardhmen.

Këshilli Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Krijimi i besimit dhe mirëkuptimit reciprok midis qeverisë dhe OSHC-ve kërkon krijimin e mundësive të rregullta për dialog dhe shkëmbim pikëpamjesh mbi sfidat kryesore me të cilat përballen të dy palët, në përpjekjet e tyre për përmirësimin e mjedisit për zhvillimin e shoqërisë civile. Megjithatë ekzistojnë disa organe këshillimtare sektoriale, nga takimet e hapura konsultuese me OSHC-të rezultoi nevoja për ngritjen e një organi këshillimor shtetëror ndërsektorial, që do të mundësonte ndërveprim të vazhdueshëm mes aktorëve kyç mbi të gjitha çështjet e politikës së zhvillimit të shoqërisë civile. Bazuar nga takimet e zhvilluara, draftligji është duke u përgatitur për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Vizioni i Këshillit Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile është që të bëhet një forum kombëtar i njohur gjerësisht për adresimin e çështjeve strategjike kyçe, duke i paraprirë trendeve dhe duke përcaktuar agjendën e ardhshme për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i Këshillit Kombëtar është të mundësojë dialog të rregullt dhe të strukturuar kuptimplotë të organeve shtetërore me përfaqësuesit e OSHC-ve mbi çështjet kyçe të zhvillimit të shoqërisë civile në Shqipëri.

Objektivat kryesorë të Këshillit duhet të fokusohen në këto drejtime:

- T'i japë këshilla strategjike Këshillit të Ministrave mbi hartimin e politikave shtetërore që synojnë arritjen e mjedisit mundësues për shoqërinë civile;

- Të garantojë pjesëmarrje në planifikimin e modeleve të mbështetjes shtetërore për shoqërinë civile;

- Të rekomandojë përmirësime në kuadrin legjislativ për punën e OSHC-ve;

- Të zbatojë në praktikë parimin e partneritetit gjatë programimit të asistencës së para-anëtarësimit të BE-së për sektorin e shoqërisë civile;

- Të garantojë monitorim të pavarur dhe objektiv të të gjithë financimit publik që jepet për programet e OSHC-ve, bazuar në raportet e përgatitura nga ministritë, organet publike dhe agjenci, përfshi AMSHC-në;

- Të gurmtojë progresin e bërë në zbatimin e standardeve të konsultimeve publike me OSHC-të, në lidhje me hartimin e legjislacionit të ri.

Aksione të propozuara:

2.1 Miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për ngritjen e Këshillit Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, si organ këshillimor ndërsektorial i qeverisë, ku marrin pjesë përfaqësues të ministrave dhe agjencive shtetërore përgjegjëse për fushat kryesore që prekin OSHC-të, si edhe përfaqësues të OSHC-ve të përzgjedhur mbi bazën e kriterëve dhe procedurave të parashikuara në këtë vendim;

2.2 Organizimi i procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të OSHC-ve në Këshill, pas një ftese publike dhe duke respektuar parimet e transparençës dhe gjithëpërfshirjes;

2.3 Sigurimi i mbështetjes efikase administrative dhe profesionale për Këshillin (duke përfshirë përgatitjen e materialeve për të gjitha sesionet dhe duke siguruar ndjekjen e të gjitha konkluzioneve të Këshillit), duke caktuar numër të mjaftueshëm të personelit kompetent nga institucioni përkatës që do të mandatohet për të vepruar si sekretariat për Këshillin.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Organizimi i workshopit mbi planifikimin strategjik, për anëtarët e rinj të Këshillit, që të krijohet platformë e përbashkët për punën e përbashkët në periudhën në vijim;

- Realizimi i një programi trajnues për anëtarët e Këshillit që të njihen me praktikatat më të mira të organeve ndërsektoriale të ngjashme, si edhe me përfaqëset metodologjike për monitorimin e politikave

shtetërore që synojnë zhvillimin e shoqërisë civile;

- Zhvillimi i aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve të sekretariatit të Këshillit, veçanërisht në lidhje me përgatitjen efikase të materialeve për seancat e Këshillit, analiza solide dhe aftësi raportimi etj.;

- Nxitja e krijimit të organeve këshillimore ndërsektoriale të ngjashme, në nivel njësie të qeverisjes vendore, si shtysë e vyer në krijimin e besimit dhe sensibilizimin e mbi rolin e OSHC-ve në zhvillimin e komunitetit vendor.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) u ngrit në 2009, në zbatim të ligjit për organizimin dhe funksionimin e AMSHC-së. Vizioni i AMSHC-së mund të përmbledhet si vijon: qytetari aktive dhe shoqëri civile aktive në Shqipëri. Misioni i AMSHC-së, sipas ligjit, është nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimi i kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut. Për realizimin e misionit, AMSHC-ja ofron asistencë financiare për programet që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndër-sektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filan-tropinë, vullnetarizmin e institucionet demokratike të shoqërisë, si dhe programe të tjera që lehtësojnë përmbushjen e misionit të saj. Ligji përcakton se, në ushtrimin e veprimtarisë së saj, AMSHC-ja udhëhiqet nga prioritetet strategjike të qeverisë për zhvillimin e shoqërisë civile.

Objektivat e AMSHC-së janë:

- nxitja e zhvillimit të vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në zhvillimin e komunitetit;
- promovimi dhe forcimi i kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së OJF-ve;
- zhvillimi i bashkëpunimit dhe partneritetit ndërsektorial ndërmjet OSHC-ve;
- rritja e vizibilitetit dhe ndikimit publik në OSHC-të;
- zhvillimi i sipërmarjes sociale dhe punësimit në OJF-të;
- rritja e ndikimit të shoqërisë civile në politikëbërje dhe vendimmarrje;
- nxitja e bashkëpunimit me OJF-të që kanë rol në luftën kundër korrupsionit, trafikimit të qenieve njerëzore dhe trajtimit të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj fëmijëve.

Konsultimet e hapura me OSHC-të konfirmuan shpresën e madhe të Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) si mekanizëm qendror për financimin publik të programeve të OSHC-ve në Shqipëri, sidomos për ripërcaktimin e rolit dhe punës së saj që të jetë më proaktive dhe afër OSHC-ve në nivel vendor, programimin më transparent të prioriteteve të financimit, mbledhjen e të dhënave të besueshme mbi OSHC-të dhe mbështetjen e zhvillimit të balancuar të shoqërisë civile në të gjithë vendin. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përgatitjes së kriterëve dhe procedurave të qarta për alokimin e granteve institucionale për OSHC-të, pasi ato janë shtysa kryesore për qëndrueshmërinë e OSHC-ve të udhëhequra drejt misionit.

Nevojitet forcim i mëtijshëm i kapaciteteve të stafit të Agjencisë, në mënyrë që të fitojë besimin e shoqërisë civile dhe të publikut të gjerë në integritetin dhe ndershmërinë e saj. Edhe pse AMSHC-ja aktualisht ka 13 punonjës, mbeten të ulëta kapacitetet e tyre për menaxhimin e procedurave komplekse të dhënies së granteve, për monitorimin dhe vlerësimin e projekteve të shpallura fituese, si edhe për dhënien e mbështetjes për OSHC-të. Vëmendja e duhur i duhet kushtuar edhe transparencës së procedurës së punësimit të stafit të Agjencisë, me qëllim që të forcohet imazhi institucional i saj. Gjithashtu, AMSHC-ja ka nevojë për asistencë shtesë që të forcohet vizibiliteti dhe pesha e saj.

Për monitorim shtesë të efektivitetit të punës së AMSHC-së dhe sinkronizimin e prioriteteve për financim si me planet strategjike kombëtare, ashtu edhe me nevojat e OSHC-ve, AMSHC-ja duhet të marrë pjesë aktive në punën e Këshillit Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile dhe të dorëzojë raportet vjetore të financimit publik të OSHC-ve pranë Këshillit Kombëtar për diskutim dhe vlerësim. Draftligji për Këshillin Kombëtar parashikon mundësinë e AMSHC-së për të luajtur rolin e sekretariatit të Këshillit, e cila do të saktësohet gjatë konsultimeve publike, duke marrë në konsideratë misionin dhe kapacitetet e AMSHC-së.

Aksione të propozuara:

2.4 Përgatitja e një strategjie afatgjatë të AMSHC-së për arritjen e objektivave kryesorë të parashikuar në statutin e saj;

2.5 Hartimi i planit të komunikimit, informimit dhe angazhimit që t'i përgjigjet kërkesave në rritje për informim dhe mbështetje nga OSHC-të vendore;

2.6 Organizimi i asistencës teknike të BE-së për AMSHC-në që të ndërtojë kapacitetet për menaxhimin e fondeve të BE-së për shoqërinë civile në të ardhmen.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Përgatitja e manualit dhe zhvillimi i programit trajnues për stafin e AMSHC-së mbi procedurat transparente dhe efektive të dhënies së granteve, në përputhje me standardet e BE-së (sidomos në

kontekstin e decentralizimit të menaxhimit të fondeve të BE-së për sektorin e shoqërisë civile në të ardhmen);

- Organizimi i *workshop*-eve trajnuese për AMSHC-në mbi konsultimet efektive me OSHC-të në programimin e prioriteteve për financim për periudhën buxhetore në vazhdim;

- Asistimi i AMSHC-së në diversifikimin e modeleve të mbështetjes së OSHC-ve (përfshi ngritjen e fundit për bashkëfinancimin e projekteve të BE-së dhe përgatitjen e sistemit për alokimin e granteve institucionale OSHC-ve;

- Rikonceptimi i faqes së internetit të AMSHC-së dhe përgatitja e strategjisë së re të komunikimit që do të përmirësonte vizibilitetin e punës së AMSHC-së;

- Ngritjen e një databaze publike të OSHC-ve që ndihmon në zbatimin e strategjisë së komunikimit të AMSHC-së, por edhe rrit vizibilitetin e projekteve të financuara nga buxheti i shtetit;

- Organizimi i *workshop*-eve rajonale për ftesat për propozime të AMSHC-së, me qëllim që të informohen aplikantët potencialë mbi kërkesat e skemës së grantit;

- Implementimi i aktiviteteve për forcim kapacitetesh për OSHC-të lokale, veçanërisht nga pikëpamja e decentralizimit të shërbimeve sociale, në linjë me planet e administratës dhe reformës territoriale.

Njësia e Koordinimit të Politikave të Shoqërisë Civile në Kryeministri

Politikat e shoqërisë civile prekin një sërë fushash nën kompetencën e një sërë ministrish, organesh shtetërore dhe agjencish. Arritja e progresit drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile kërkon koordinim solid vertikal dhe horizontal të politikave. Kjo mund të arrihet duke ngritur një njësi për koordinimin e politikave të shoqërisë civile pranë Departamentit të Zhvillimit të Programimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj.

Vizioni i njësies është partneriteti i fortë ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave publike.

Misioni i njësies është t'ua lehtësojë OSHC-ve punën me shtetin dhe krijimi i mjedisit ligjor, financiar dhe institucional mundësues për OSHC-të, me qëllim që të rritet impakti i tyre në shoqëri.

Për këtë qëllim, njësia duhet të kryejë shërbime eksperte, analitike dhe administrative për forcimin e bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile, si dhe në veçanti duhet të kryejë këto detyra:

- Koordinimin, formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve strategjike që prekin mjedisin për zhvillimin e shoqërisë civile;

- Propozimin e përmirësimeve në kuadrin legjislativ për punën e OSHC-ve;

- Harmonizimin e kriterëve, standardeve dhe prioriteteve për financimin e projekteve dhe programeve të OSHC-ve nga organet shtetërore dhe institucione publike të tjera;

- Koordinimin e punës së organeve të administratës publike në konsultimin dhe përfshirjen e OSHC-ve në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit të ri dhe politikave publike me interes të përgjithshëm;

- Koordinimin e zhvillimit të programeve trajnuese për nëpunësit civilë mbi bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile;

- Koordinimin e programimit të projekteve dhe programeve të paraanëtarësimit në BE dhe i fondeve strukturore në mbështetje të zhvillimit të shoqërisë civile;

- Garantimin e mbështetjes administrative dhe eksperte për Këshillin Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile dhe organeve të tjera këshillimore sipas vendimit të Këshillit të Ministrave;

- Në kontekstin e decentralizimit të fondeve të BE-së për shoqërinë civile në Shqipëri në të ardhmen e afërt, duhet të mbahet parasysh nevoja për ndarjen institucionale të përgjegjësisë në lidhje me programimin (Njësia për shoqërinë civile në Kryeministri), kontraktimin dhe financimin (Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile).

Aksione të propozuara:

2.7 Ndryshimi i rregullores për strukturën organizative të Kryeministrisë për të mundësuar ngritjen e një njësie për koordinimin e politikave të shoqërisë civile brenda Departamentit të Zhvillimit të Programimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj;

2.8 Sigurimi i burimeve financiare dhe njerëzore të mjaftueshme për punën efektive të njësies.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Mbështetje për hartimin e metodologjisë për mbledhjen e të dhënave mbi financimet publike të OSHC-ve, analizën, interpretimin dhe paraqitjen e tyre për qëllime të raportimit cilësor pranë qeverisë dhe për të përmirësuar programimin e prioriteteve për investime me fonde të brendshme publike apo të BE-së/ndërkombëtare;

- Asistim në zhvillimin dhe menaxhimin e një databaze publike me të gjitha grantet e dhëna për projektet dhe programet e OSHC-ve nga fondet publike, përfshi financimet e BE-së;

- Mbështetje në zbatimin e programeve trajnuese për nëpunësit civilë mbi zhvillimin e bashkëpunimit me

OSHC-të në formësimin e politikave publike.

Njësitë/personat e kontaktit për bashkëpunimin me OSHC-të në ministrinë dhe organet e tjera shtetërore dhe institucionet publike

Ngritja e Agjencisë, Këshilli Kombëtar apo Njësitë për bashkëpunimin me OSHC-të nuk duhet të zëvendësojë dialogun e rregullt dhe të hapur të të gjitha organeve publike me OSHC-të dhe qytetarët në kryerjen e detyrave të përditshme në përmbushje të qëllimeve strategjike brenda fushave të tyre të veprimit. Veçanërisht, kjo nuk duhet të konsiderohet si justifikim për mungesën e komunikimit të mirëfilltë mes ministrive/agjencive shtetërore dhe shoqërisë civile. Përfshirja e OSHC-ve në procesin e vendimmarrjes në të gjithë sektorët është mjet i shkëlqyer për transformim gradual të stileve të qeverisjes dhe përjasjet e menaxhimit të politikave publike.

Prandaj, është e rëndësishme që çdo organ publik të emërojë një person kontakti apo edhe të krijojë njësi të posaçme për bashkëpunimin me OSHC-të, me fushë të gjerë veprimi për komunikimin dhe bashkëpunimin në zbatimin e politikave specifike apo në ofrimin e shërbimeve sociale. Hap mjaft pozitiv në këtë drejtim ka qenë krijimi i Sektorit të Shoqërisë Civile dhe Strategjisë pranë Drejtorisë së Jetësimit të Prioriteteve dhe Sekretariatit Evropian në Ministrinë e Integritimit Evropian.

Procesi i emërimit të koordinatorëve për konsultime publike në çdo organ publik është parashikuar nga projektligji për njoftimin dhe konsultimin publik. Kjo shërben si shtysë për të planifikuar masa më sistematike të forcimit të bashkëpunimit mes të gjitha institucioneve publike dhe aktorëve të shoqërisë civile të organizuar.

Aksione të propozuara:

2.9 Emërimi i personave të kontaktit dhe, sipas nevojës, ngritja e njërive të posaçme për bashkëpunimin me OSHC-të në ministri dhe organe shtetërore të tjera;

2.10 Publikimi i listës së personave të kontaktit me hollësi relevante, në faqet e internetit të të gjitha ministrive/organeve publike;

2.11 Organizimi i takimeve periodike koordinuese me personat e kontaktit (detyrë e mundshme e njësisë për shoqërinë civile në Kryeministri).

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Organizimi i programeve trajnuese për të gjitha pikat e kontaktit mbi bashkëpunimin me OSHC-të dhe/ose punonjësit e njërive të bashkëpunimit me OSHC-të.

Institucionet përgjegjëse: KM, MIE, MF, AMSHC

3. PËRFSHIRJA OSHC-ve NË PROCESIN E POLITIKËBËRJES

Është fakt se komunikimi i qenësishëm dhe efektiv me publikun e interesuar është thelbësor për procesin e rritjes së nivelit të besimit të publikut, si edhe i mundëson qeverisë të përmirësojë llogaridhënien e organeve publike. Megjithatë, në praktikën e përditshme, organet shtetërore të të gjitha niveleve shpesh përballen me sfida në përgatitjen dhe mbajtjen e konsultimeve mbi politikën, sidomos në dhënien e *feedback*-ut të duhur pjesëmarrësve në lidhje me rezultatet e konsultimeve publike.

Shpesh iu është kujtuar OSHC-ve rëndësia e procedurave të qarta dhe rregullave detyruese për përfshirjen e publikut të interesuar në procesin e vendimmarrjes, por edhe nevoja për ndërtimin e kapaciteteve të nëpunësve civilë për përfshirje efektive të aktorëve joshetërore në përgatitjen e politikave publike të reja.

Siç konstaton raporti i SIGMA 2014, detyrimi për t'u konsultuar me shoqërinë civile është parashikuar në legjislacion, por ende mungojnë procedurat formale precize. Rregullat e procedurës përcaktojnë se konsultimet duhet të jenë pjesë integrale e procesit të përgatitjes së politikave. Manuali për hartimin e legjislacionit u jep ministrive orientimet në lidhje me zhvillimin e konsultimeve. Megjithatë, përjasja aktuale ndaj konsultimeve nuk ndjek gjithmonë disa parametra të paracaktuar cilësie. Për të adresuar këto mangësi, dhe në kontekstin e angazhimeve të qeverisë në kuadrin e Nismës së Partneritetit për Shoqëri të Hapur, qeveria bashkë me organizatat e shoqërisë civile përgatiti projektligjin për njoftimin dhe konsultimin publik, që synon të vendosë një kuadër të qartë për konsultimet. Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe konsultimit publik për projektligjet, projektdokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, si edhe politikën me interes publik të lartë. Pritet që ky ligj të përcaktojë rregullat procedurale përmes të cilave garantohet transparenca dhe pjesëmarrja e publikut në politikëbërje. Qeveria ka zhvilluar një konsultim publik mbi këtë projektligj dhe ka marrë një numër të madh sugjerimesh që prekin një gamë të gjerë çështjesh.

Për t'iu përgjigjur kërkesave për konsultime më të qenësishme me komunitetin e biznesit dhe partnerët socialë, qeveria ngriti Këshillin Kombëtar Ekonomik (KKE) që ka filluar punën në vitin 2014. KKE-ja do të këshillojë qeverinë mbi çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik dhe pritet të rritë transparençën në vendimmarrjen publike dhe përfaqësimin e sektorit privat në këtë proces.

Aksione të propozuara:

3.1 Miratimi i projektligjit për njoftimin dhe konsultimin publik në Kuvend, si edhe i akteve nënligjore;

3.2 Krijimi i regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike;

3.3 Përgatitja e manualit me udhëzime hap pas hapi për nëpunësit civilë mbi zhvillimin e konsultimeve publike efektive;

3.4 Përgatitja e metodologjisë për raportimin vjetor të rezultateve të konsultimeve publike dhe rritja e transparencës së procesit të vendimmarrjes, me informimin e duhur mbi numrin e akteve të miratuara nga organi publik gjatë vitit të caktuar, numrin e rekomandimeve që u kanë shkuar aktorëve, numrin e rekomandimeve dhe komenteve të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes dhe numrin e takimeve publike të organizuara;

3.5 Dhënia e çmimit kombëtar vjetor për praktikantët më të mira në lidhje me transparencën dhe gjithëpërfshirjen e procesit të vendimmarrjes në organet publike;

3.6 Krijimi i një programi trajnues për nëpunësit civilë, i drejtuar nga Shkolla Shqiptare për Administratën Publike, fokusuar në bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile në politikëbërjen publike.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

-Mbështetje e organizimit të trajnimeve sistematike për koordinatorët e emëruar mbi njoftimin dhe konsultimin publik në të gjitha organet publike, si edhe për nëpunësit civilë të tjerë (që punojnë në departamentet ligjore apo të burimeve njerëzore);

-Organizimi i fushatave të sensibilizimit publik për të paraqitur mundësi të reja për përfshirjen e qytetarëve, OSHC-ve dhe publikut të interesuar në konsultimet mbi politikat publike të reja;

-Organizimi i çmimit kombëtar vjetor për praktikantët më të mira për transparencën dhe gjithëpërfshirjen e procesit të vendimmarrjes në organet publike.

Institucionet përgjegjëse: MIE, AMSHC

4. KUADRI I FINANCIMIT PUBLIK PËR PROGRAMET E OSHC-ve

OSHC-të shqiptare mbeten shumë të varura nga financimi i huaj, që për momentin nuk i plotëson nevojat e sektorit të OSHC-ve dhe për më tepër është duke u pakësuar. Mundësitë e brendshme të financimit janë të pakta, ndërsa financimi i shtetit për OSHC-të përfshin kontraktimin për ofrimin e shërbimeve dhe dhënien e granteve për projekte përmes ministrive të linjës dhe Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (ASCS). ASCS ofron grante për OSC-të për të financuar projekte që fokusohen në luftën kundër korrupsionit, pjesëmarrjen e qytetarëve, iniciativat advokuese, dhuna në familje, punësimi, etj. Tre vitet e fundit, ASCS-ja ka kryer katër runde të skemave të granteve. Janë dhënë grante të vogla deri në 1.000.000 lekë për 213 OSHC. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka kontraktuar OSHC-të për të drejtuar një numër shërbimesh si qendrat e kujdesit, qendrat e trajnimit dhe arsimit, si dhe ato të formimit profesional. Gjithashtu, një numër projektesh të OSHC-ve janë financuar nga ministritë e tjera, veçanërisht në fushat e kulturës, artit, sportit, trashëgimisë kulturore dhe rinisë.

Një nga rreziqet më të mëdha për qëndrueshmërinë e punës së OSHC-ve është mungesa e rregullave dhe procedurave të qarta për financimin publik të programeve të OSHC-ve dhe kontraktimi i OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve sociale. Në këtë moment, procedurat për shpërndarjen e fondeve publike janë përshtatshme vetëm në ligjin për Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (ASCS) dhe rregulloret e tjera të brendshme të ASCS-së. Meqenëse ekzistenca e vetë ASCS-së nuk është e mjaftueshme për të përmbushur të gjitha nevojat për financimin e programeve të OSHC-ve dhe ofrimin e shërbimeve sociale, është e nevojshme të investohet në vendosjen e rregullave, standardeve dhe procedurave të qarta për alokimin e fondeve publike për OSHC-të në të gjitha nivelet, veçanërisht njësitë e qeverisjes vendore. Prandaj, është e nevojshme të miratohet një rregullorë e re që do të mundësonte vendosjen e sistemit të qartë të financimit publik, me rregulla të sakta për çdo fazë të procesit të marrjes së grantit, përfshi monitorimin dhe vlerësimin. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh pengesat e shumta me të cilat OSHC-të po përballen për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit të zyrtarëve publikë për instrumentet ligjore ekzistuese për sigurimin e shërbimeve nëpërmjet sektorit jofitimprurës dhe të gjitha përfitimeve që rrjedhin nga kontraktimi i OSHC-ve. Ndërgjegjësimi i ulët i organeve të administratës publike për avantazhet e partneritetit me OSHC-të për zgjidhjen e problemeve të komunitetit vendor është ndër pengesat më të mëdha për diversifikimin e burimeve të financimit dhe modelet e mbështetjes për OSHC-të. Nevojiten rregulla të qarta për alokimin e fondeve publike dhe kontraktimin e OSHC-ve për të kapërcyer paragjykimet dhe shumë sfida të tjera ekzistuese në këtë fushë.

Me perspektivat për decentralizimin e shërbimeve sociale, në linjat me planet e reformave administrative dhe territoriale është e nevojshme për të forcuar kapacitetet e njësitë të qeverisjes vendore për partneritet me OSHC-të si aktorë të pashmangshëm në sigurimin me cilësi të lartë të shërbimeve të përgjegjshme sociale të arritshme. Sipas praktikave më të mira të BE-së të gjithë ofruesit e shërbimeve sociale, OSHC-të duhet të jenë të licencuar, me përvojë, të vlerësuar dhe të rregulluar me një sistem të standardizuar kombëtar

dhe të monitoruar nga institucionet përgjegjëse të shërbimit social të standardeve të ofrimit të inspektimeve. Kjo do të kërkojë ndryshimet e nevojshme ligjore që do të lejojnë që ofrimi i shërbimeve nga OSHC-të të jetë i integruar plotësisht në sistemin e qeverisjes lokale të ofrimit të shërbimeve dhe në të njëjtën kohë i politikës së përfshirjes sociale dhe strategjisë së mbrojtjes sociale.

Aksione të propozuara:

4.1 Ndryshimi i ligjit për organizatat jofitimprurëse me nene të reja për mbështetjen shtetërore të OJF-ve, që siguron bazën ligjore për miratimin e akteve nënligjore (rregullore), për përcaktimin e standardeve, parametrave dhe kriterëve të qarta për alokimin e fondeve publike për programet e OSHC-ve, përfshin kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve sociale si në nivel kombëtar dhe vendor të qeverisjes, por edhe për përcaktimin e bazës për përparimin domethënës në transparencën e procedurave të alokimit të fondeve dhe disponueshmërinë e të dhënave të hollësishme mbi rezultatet e thirrjeve për propozime.

4.2 Krijimi i një databaze publike me informacion të detajuar rreth të gjitha granteve nga buxheti i shtetit për OSHC-të, ku organizatat dhe ministritë/ institucionet publike mund të gjejnë informacion.

4.3 Përgatitja e raporteve vjetore për financimin e përgjithshëm publik për programet e OSHC-ve me analizë të detajuar të fushave kryesore dhe të përfituesve të granteve, si dhe të dhëna të sakta mbi punën e të gjitha organeve publike që ofrojnë financim për programet e OSHC-ve, në drejtim të respektimit të standardeve, parimeve dhe procedurave të vendosura nga rregullorja.

4.4 Krijimi i një sistemi të përbashkët informativ mbi financimin publik të OSHC-ve për të mundësuar koordinim dhe shkëmbim informacioni në kohë reale dhe efektiv ndërmjet të gjitha organeve publike që financojnë programet e OSHC-ve.

4.5 Amendimi ose miratimi i akteve të reja ligjore në fushën e prokurimit publik, standardizimit dhe licencimit të shërbimeve sociale, në mënyrë që të mundësojë kontraktimin efektiv të OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve sociale.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Hartimi dhe zbatimi i programit trajnues për nëpunësit civilë në të gjitha nivelet për të siguruar zbatimin normal të rregullave të reja të financimit publik dhe procedurave të OSHC-ve, me theks të veçantë në standardet e ofrimit të shërbimeve sociale dhe nëpunësve civilë që kanë të bëjnë me prokurimin.

- Përgatitja e një manuali për nëpunësit civilë për financimin publik të programeve të OSHC-ve, përfshi bashkëpunimin në ofrimin e shërbimeve sociale.

- Mbështetje për zhvillimin e metodologjisë për mbledhjen e të dhënave dhe asistimi për përgatitjen e raporteve vjetore mbi financimin e përgjithshëm publik për programet e OSHC-ve.

Institucionet përgjegjëse: MIE, AMSHC, MF

5. KUADRI LEGJISLATIV PËR REGJIS-TRIMIN DHE PUNËN E OSHC-ve

Aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile (OSHC-të) rregullohen kryesisht me ligjin për shoqëritë jofitimprurëse dhe ligjin mbi regjistrimin e organizatave jofitimprurëse. Themelimi, regjistrimi, funksionimi, organizimi dhe veprimtaria e OSHC-ve rregullohet me ligjin për organizatat jofitimprurëse (nr. 8788, 2001/07/05). OJF-të përfshijnë: 1. organizatat e anëtarësimit me të paktën pesë persona ose dy entitete ligjore si anëtarë themelues dhe asamblenë e përgjithshme si organin më të lartë vendimmarrës; dhe 2. fondacionet dhe qendrat që mund të krijohen nga një ose më shumë persona ose me testament dhe të kenë bordin e drejtorëve si organin më të lartë vendimmarrës.

Ligji aktual për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse (OJF-ve) parashikon sistem të centralizuar të regjistrimit të OJF-ve vetëm në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Vendimi për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo vendim tjetër në lidhje me veprimet që lidhen me regjistrimin e tyre, merret nga një gjyqtar i vetëm i seksionit tregtar të gjykatës pas aplikimit të subjektit të interesuar. Rregullat e tanishme të regjistrimit konsiderohen mjaft diskriminuese ndaj organizatave me bazë jashtë Tiranës. Veçanërisht, centralizimi i sistemit të regjistrimit të organizatave jofitimprurëse vetëm në Gjykatën e Tiranës nënkupton shpenzime shtesë për OJF-të jashtë kryeqytetit, të gatshme për të regjistruar një organizatë jofitimprurëse. Kjo mund të konsiderohet si faktor demotivues dhe rëndues për zhvillimin e balancuar rajonal të shoqërisë civile në Shqipëri. Sipas raportit të vlerësimit të nevojave nga zyra TACSO Shqipëri në vitin 2013, shumica e OSHC-ve janë të përqendruara në Shqipërinë qendrore, veçanërisht në Tiranë. OSHC-të e tjera janë nga qytetet e mëdha në veri (Shkodër) dhe në jug (Korçë, Fier dhe Vlorë). Sektori i shoqërisë civile është i dobët në rrethet e largëta dhe veçanërisht në zonat rurale, ndërsa numri i grupeve aktive joformale me bazë komuniteti është shumë i ulët.

Decentralizimi i procesit të regjistrimit të organizatave jofitimprurëse do të lejojë akses më të mirë në organet e regjistrimit në nivel vendor. Kjo kërkon ndryshime në ligjin aktual për regjistrimin e OJF-ve, që do të thotë, rregullimi i gjithë procedurës së regjistrimit të organizatave jofitimprurëse në organet kompetente (gjykatat).

Aksione të propozuara:

5.1 Ndryshimi i ligjit aktual për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse për të mundësuar decentralizimin e procesit të regjistrimit të OJF-ve;

5.2 Përgatitja e udhëzimeve të hollësishme për organet kompetente të regjistrimit në nivel vendor për të siguruar zbatimin e harmonizuar të ligjit;

5.3 Hartimi i programit trajnues për organet kompetente (gjykatat) për regjistrimin e OJF-ve;

5.4 Krijimi i sistemit të përbashkët informativ elektronik që lidh të gjitha organet e regjistrimit në nivel vendor dhe që mundëson përditësimin automatik të informacionit për të gjitha OJF-të e regjistruara.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Përgatitja e udhëzimeve dhe ofrimi i programit trajnues për organet e regjistrimit për të siguruar zbatimin e harmonizuar të ligjit.

- Përgatitja dhe vënia në funksion e sistemit të përbashkët informativ elektronik për organet e regjistrimit.

- Zbatimi i programit trajnues për organet e regjistrimit.

Institucionet përgjegjëse: Ministria e Financave, MIE, AMSHC

6. KONTABILITETI/RAPORTIMI FINANCIAR DHE TRAJTIMI TATIMOR I OSHC-ve

Tatimet aktuale, raportimi financiar dhe rregullat e kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse konsiderohen të rënda nga shumica e OSHC-ve. Shumë OSHC, veçanërisht ato të sapokrijuarat, shoqatat rinore, grupet e cënueshme dhe ato të marginalizuara, si dhe OSHC-të që veprojnë në zonat e largëta vështirë se përputhen me rregulloret për tatimet dhe menaxhimin financiar. Sipas ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe ligjin për inspektimin financiar publik dhe raportimin, OSHC-të kanë kontabilitet disproporcional dhe detyrime raportimi, edhe nëse nuk angazhohen në aktivitete ekonomike. Pritet gjithashtu që OSHC-të (sipas legjislacionit të sigurimeve shoqërore) të kenë të paktën një staf me kohë të plotë dhe të paguajnë të gjitha taksat, me qëllimin për të mbajtur OSHC-të funksionale. Ky lloj detyrimi e ka ulur ndjeshëm numrin e organizatave aktive në Shqipëri meqë shumë prej tyre nuk mund të përballojnë përmbushjen e këtyre kriterëve. Përveç kësaj, legjislacioni në fuqi nuk parashikon diferencim të qartë ndërmjet aktiviteteve ekonomike dhe atyre jofitimprurëse, si dhe mungojnë udhëzimet e sakta nga organizatat tatimore për OSHC-të për aktivitetet ekonomike të lejuara. Ligji i ri për tatimin mbi vlerën e shtuar (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 128, 13 gusht 2014), i cili hyn në fuqi më 1 janar 2015, përpaket të sjellë më shumë qartësi në këtë fushë.

Kërkesat e raportimit ekzistues, përveç të qenit të papërshtatshme dhe të rënda, nuk mundësojnë kryerjen e statistikave të rregullta dhe të besueshme për sektorin jofitimprurës. Me futjen e rregullave të veçanta të kontabilitetit dhe të raportimit financiar për sektorin jofitimprurës, mund të merren parasysh specifikat e menaxhimit të organizatave jofitimprurëse, gjithashtu duke marrë parasysh parimin e proporcionalitetit, veçanërisht për organizatat më të vogla dhe ato që nuk angazhohen në aktivitete ekonomike. Rregullat më të hollësishme dhe specifike për OJF-të do të mundësojnë kryerjen e statistikave më të avancuara për zhvillimin e sektorit jofitimprurës (d.m.th. të ardhurat e përgjithshme, burimet e financimit, asetet, numri i të punësuarve, numri i vullnetarëve etj.) që janë të rëndësishme për programimin, monitorimin dhe vlerësimin e financimit të programeve të OSHC-ve.

Përfshirja në mënyrë të qartë dhe eksplicite nga taksat për grantet duhet të përfshihet në ligj (dhe jo udhëzimet e Ministrisë së Financave ose aktet e tjera nënligjore) për të parandaluar ndonjë keqinterpretim mbi këtë çështje nga autoritetet tatimore vendore.

Në lidhje me trajtimin tatimor/fiskal të donatorëve të OSHC-ve, aktualisht nuk ekzistojnë incentiva për personat që dëshirojnë të japin donacione për programet e OSHC-ve. Njohja në legjislacionin tatimor të donacioneve për OSHC-të si shpenzime të zbritshme do të nxiste filantropinë individuale dhe do të kontribuonte në qëndrueshmërinë e përpjekjeve për zhvillimin e shoqërisë civile. Kur është fjala për bizneset që paguajnë tatimin standard mbi fitimin, ata mund të pretendojnë shpenzime të zbritshme nga donacionet (klasifikuar si "sponsorizim" biznesi) për OSHC-të deri në 4% të të ardhurave të tatueshme. Për sipërmarrësit që paguajnë "taksën e biznesit të vogël", tatimi mbi donacionet mund të zbritet deri në 1% të të ardhurave të tatueshme. Megjithatë, bizneset vetëm rrallë e shfrytëzojnë atë, kryesisht për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit dhe njohjes publike të këtyre investimeve sociale.

Ky është parakusht për ndërtimin e besimit të publikut në punën e OSHC-ve dhe forcimin e besueshmërisë së përpjekjeve të OSHC-ve për avokimin publik në të gjitha fushat e politikave.

Aksione të propozuara:

6.1 Hartimi i një projektakti të veçantë për operacionet financiare dhe kontabilitetin e OJF-ve që merr parasysh specifikat e menaxhimit të tyre;

6.2 Hapja e debatit publik për rishikimin e modeleve të raportimit financiar për OJF-të për të mundësuar mbledhjen/grumbullimin e të dhënave cilësore për sektorin jofitimprurës;

6.3 Ndryshimi i legjislacionit fiskal aktual për të njohur donacionet për OSHC-të si shpenzime të zbritshme, me qëllim që të nxitet filantropia individuale dhe të kontribuohet në qëndrueshmërinë e përpjekjeve të shoqërisë civile;

6.4 Analizimi i impaktit të kërkesës aktuale ligjore që e detyron çdo OSHC të regjistruar që të ketë të paktën një punonjës për të cilin është paguar sigurimi shëndetësor dhe social;

6.5 Krijimi i një databaze qendrore on-line me të gjitha raportet financiare të organizatave jofitim-prurëse që mund të bëhen publike, me synimin për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e organizatave jofitimprurëse.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Përgatitja e manualit për autoritetet tatimore dhe OSHC-të për trajtimin tatimor dhe aktivitetet ekonomike që mund të ndërmerren nga sektori jofitimprurës;

- Kryerja e programeve trajnuese për administratën tatimore mbi trajtimin e tatimeve / TVSH të organizatave jofitimprurëse për të siguruar zbatimin e harmonizuar të rregullave në të gjitha nivelet e administratës tatimore;

- Krijimi i modeleve të reja të raportimit financiar që do të mundësojnë përgatitjen e statistikave më të avancuara për OSHC-të;

- Nisja e fushatës së ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e zhvillimit të filantropisë individuale dhe të përbashkët si parakushte thelbësore për qëndrueshmërinë e programeve të përfitimit publik të OSHC-ve.

Institucionet përgjegjëse: MF, AMSHC.

7. MBLEDHJA DHE DISPONUESHMËRIA E TË DHËNAVE PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

Disponueshmëria dhe cilësia e të dhënave për tendencat e zhvillimit të shoqërisë civile është me rëndësi strategjike për vlerësimin më cilësor të nevojave dhe programimin e ardhshëm të modeleve, si dhe rritja e mbështetjes ndaj shoqërisë civile nga burimet financiare të brendshme dhe ato ndërkombëtare, publike dhe private. Aktualisht, nuk ka ende të dhëna të besueshme zyrtare në dispozicion për numrin e përgjithshëm të OSHC-ve të regjistruara në vend.

Sipas të dhënave të Njësisë së Inteligjencës Financiare të mbledhura për qëllime të indeksit të qëndrueshmërisë së OSHC-ve USAID 2012, ekzistojnë 1651 OSHC të regjistruara nga organet tatimore në Ministrinë e Financave të Shqipërisë. Raporti i fundit i vlerësimit të nevojave TACSO 2013 përmend rreth 3000 OSHC të regjistruara (2,231 shoqata, 311 fondacione dhe 552 qendra). Megjithatë, këto nuk janë të dhëna zyrtare, meqenëse Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, si organi i vetëm qendror për regjistrimin e OSHC-ve në Shqipëri, nuk mban të dhëna elektronike dhe për këtë arsye nuk është në gjendje të sigurojë një numër të saktë të OSHC-ve të regjistruara ose t'i bëjë ato të disponueshme nëpërmjet internetit përmes një databaze të aksesueshme. Për këtë arsye, nuk është e mundur të ndiqen trendet e regjistrimit të OSHC-ve në pjesë të ndryshme të vendit dhe në sektorë të ndryshëm të aktiviteteve. Mungesa e databazës në faqen zyrtare dhe publike të OSHC-ve gjithashtu mund të konsiderohet si pengesë e rëndësishme për ndërtimin e besimit të publikut në punën e OSHC-ve.

Përveç të dhënave themelore për numrin dhe profilin e OSHC-ve, është e nevojshme të ndiqen edhe të dhënat e tjera që mund të japin ndikimin social të programeve dhe vlerësimin e kontributeve të OSHC-ve në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik, si: numri i të punësuarve, të ardhurat e përgjithshme, burimet e financimit, pasuritë, numri i punonjësve, numri i vullnetarëve etj. Kjo do të kërkojë ndryshime në legjislacionin aktual për regjistrimin dhe raportimin e OSHC-ve.

Aksione të propozuara:

7.1 Ndryshimi i ligjit aktual për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse që është rregullimi i procedurave për regjistrimin e OJF-ve, si dhe për mirëmbajtjen e regjistrit – kapitulli përkatës i ligjit (veçanërisht kapitulli III mbi formën dhe përmbytjen e regjistrit) duhet të ndryshohet në mënyrë që të lejojë krijimin e regjistrit elektronik.

7.2 Për të lejuar publikun e interesuar që të ketë akses në të dhënat themelore të OSHC-ve të regjistruara, duhet të krijohet një databazë e aksesueshme publike që do të përditësohet rregullisht me të gjithë informacionin relevant për OSHC-të (data e regjistrimit, detaje për adresat/kontaktin, sektorin(t) e aktiviteteve, emri i presidentit/ personave të tjerë të autorizuar për të përfaqësuar OSHC-në etj.) dhe të kërkueshme sipas kriterëve të ndryshme (emër, grup/ nëngrup i aktiviteteve, qyteti/ rajoni i selisë së OSHC-së, etj.).

7.3 Ndryshimi i legjislacionit aktual ose hartimi i legjislacionit të ri që rregullon raportimin financiar të OJF-ve, me qëllim që të përgatiten modele të reja raportimi që mundësojnë përgatitjen e statistikave më të avancuara për OSHC-të.

7.4 Publikimi i skedave të përditësuara me statistika kyçe për kontributin e sektorit të shoqërisë civile në

zhvillimin social dhe ekonomik të vendit, si dhe përhapja e gjerë e rezultateve.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Asistencë për zhvillimin e klasifikimit/kate-gorizimit të ri të sektorëve/nësektorëve të aktivitetëve të OJF-ve si bazë për krijimin e sistemit të ri të regjistrimit dhe krijimin e databazës publike me informacion më të detajuar mbi profilin e OJF-ve në të gjithë vendin (përfshi workshope-t e këshillimit me OSHC-të mbi kriteret për klasifikimin e sektorëve të aktivitetëve të OJF-ve).

Institucionet përgjegjëse: MF, AMSHC

8. ZHVILLIMI I VULLNETARIZMIT

Aktualisht, nuk ka një politikë shtetërore që mbështet zhvillimin e vullnetarizmit në Shqipëri. Kjo manifestohet me mungesën e kuadrit ligjor për vullnetarizmin, mungesën e incentivave shtetërore për infrastrukturën apo programet vullnetare, mungesën e të dhënave të besueshme mbi numrin e vullnetarëve, si edhe konceptet e gabuara dhe stereotipet për vullnetarizmin të përhapura që janë trashëguar nga periudha komuniste.

Mungesa e rregullimit ligjor për vullnetarizmin ka rezultuar problem në praktikë për shumë vende evropiane, gjë që ka dekurajuar vullnetarizmin dhe ka lejuar hapësira për keqpërdorim. Shumica e shteteve anëtare të BE-së kanë njohur rëndësinë e rregullimit ligjor të vullnetarizmit dhe kanë vendosur, gjatë viteve të fundit, që të rregullojnë çështjen e vullnetarizmit si me anë të legjislacionit të brendshëm, ashtu edhe me anë të akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Të gjitha vendet që kanë miratuar një ligj për vullnetarizmin rregullojnë ose mundësojnë këto drejtime: i) promovimi i vullnetarizmit si veprimtari me rëndësi të përgjithshme sociale; ii) vullnetarizmi afatgjatë dhe transkombëtar i rinisë; iii) kompensimi i kostove që rrjedhin nga vullnetarizmi; iv) sigurimi ndaj dëmtimeve; v) përcaktimi i të drejtave dhe miratimi i Kodit të Etikës për Vullnetarin.

Miratimi i një kuadri ligjor të qartë për vullnetarizmin, qartësimi i detyrimeve dhe përgjegjësi të të gjitha palëve, përfshi standardet etike dhe cilësore të vullnetarizmit, mund të kontribuojnë në zgjerimin e njohjes së punës vullnetare dhe në ndryshimin e mendësisë mbi vlerat e vullnetarizmit. Hap i mëtejshëm në këtë proces është krijimi i një infrastrukture solide me qendra vullnetare vendore, që mund të mbështeten nga shteti apo aktorë të tjerë, si edhe formimi i programeve financuese për zhvillimin e vullnetarizmit. Pas miratimit të një kuadri ligjor të qartë me përcaktimet e duhura për vullnetarizmin, si edhe ngritja e një infrastrukture solide, mund të realizohen fushata sensibilizuese dhe veprimtari për promovimin e vullnetarizmit. Për organizatorët e punës vullnetare mund të miratohen akte nënligjore për raportimin, me qëllim që të lehtësohet mbledhja e të dhënave për vullnetarizmin dhe matja e vlerës ekonomike të punës vullnetare.

Aksione të propozuara:

8.1 Miratimi i ligjit për vullnetarizmin që rregullon qartë mundësitë, të drejtat dhe detyrimet në lidhje me punën vullnetare;

8.2 Mbështetja e forcimit të qendrave vullnetare vendore në Shqipëri, si infrastrukturë e nevojshme për punën vullnetare;

8.3 Ngritja e skemave të financimit nga shteti për të mbështetur zhvillimin dhe menaxhimin e programeve vullnetare, si në OSHC, ashtu edhe në institucionet publike në mbarë vendin;

8.4 Krijimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi shpeshtësinë dhe përhapjen e veprimtarive vullnetare (mundësisht përmes akteve nënligjore specifike që përcaktojnë kriteret e raportimit për organizatorët e punës vullnetare), si edhe vlerën ekonomike të punës vullnetare;

8.5 Krijimi i Çmimit Kombëtar për punën vullnetare si pjesë e promovimit të praktikave më të mira në vullnetarizëm si edhe inkurajimi i interesit mediatik për këtë çështje.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Përgatitja e manualit për OSHC-të dhe organizatorët e tjerë të vullnetarizmit mbi zbatimin e kërkesave të reja në kuadrin e ligjit për vullnetarizmin që do të miratohet;

- Organizimi i programeve trajnuese për koordinatorët e punës vullnetare në OSHC-të dhe institucionet publike mbi menaxhimin efektiv të programeve vullnetare;

- Mbështetja e fushatës sensibilizuese kombëtare mbi vlerat e vullnetarizmit;

- Kontribut në zhvillimin e metodologjisë për mbledhjen e të dhënave mbi punën vullnetare.

Institucionet përgjegjëse: MMSR, MIE, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

9. Kontributi i OSHC-ve në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë

Siç theksohet në udhëzimet e *DG Enlargement* për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit gjatë 2014-2020, fuqizimi i shoqërisë civile luan rol të rëndësishëm në respektimin në praktikë e vlerave dhe parimeve themelore të traktateve të BE-së, në vendet që dëshirojnë të bëhen pjesë e Bashkimit. Procesi i integrimit në BE nënkupton reforma gjithëpërfshirëse që prekin të gjitha segmentet e shoqërisë

dhe pothuajse të gjithë sektorët ku OSHC-të janë aktive. Prandaj, ky proces mund të konsiderohet si katalizator për të forcuar qeverisjen e mirë dhe kulturën e dialogut midis qeverisë dhe sektorit joshpëtësor. Ministria e Integritimit Evropian ka hedhur hapa të rëndësishëm, tashmë, drejt forcimit të bashkëpunimit me OSHC-të në procesin e integritetit evropian, sidomos duke ngritur një sektor për bashkëpunimin me OSHC-të dhe pjesëmarrjes aktive në koordinimin e mbështetjes së donatorëve për OSHC-të.

Bazuar në përvojën e vendeve kandidatë dhe të shteteve anëtare të reja, roli i shoqërisë civile në procesin e integritetit evropian mund të përmbledhet si vijon:

- përfshirja direkte në negociatat e anëtarësimit (*screening*, përgatitja e pozicioneve kombëtare, mbikëqyrja e progresit);
- dialogu me qeverinë në formulim politikash dhe në harmonizim legjislativ me *acquis* të BE-së;
- monitorimi i zbatimit të legjislacionit që harmonizon *acquis* të BE-së si dhe gjurmimi i efekteve sociale të procesit të reformave;
- pjesëmarrja në programimin e financimit të asistencës së paraderimit;
- zbatimi i projekteve të rëndësishme të financuara nga BE-ja në fusha kyçe të reformave në kuadrin e integritetit evropian;
- komunikimi i temave të BE-së dhe thellimi i njohurive të qytetarëve mbi efektet sociale dhe ekonomike të reformave që ndërmerren në kuadër të integritetit evropian, duke kontribuar kështu në marrjen e vendimit të mirinformuar mbi aderimin në BE në fund të procesit të paraanëtarësimit;
- dhënie kontributi për të krijuar një strategji komunikimi me jashtë më të suksesshme për shoqërinë, përmes rrjeteve të BE-së dhe projekteve të partneritetit me OSHC-të nga shtetet anëtare, duke promovuar njohjen dhe solidaritetin trans-kombëtar, por duke ndihmuar edhe në kapërcimin e perceptimit për “lodhjen nga zgjerimi” që ekziston ndër aktorët kyç dhe qytetarët e vendeve të BE-së.

Aksione të propozuara:

9.1 Mundësimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në të gjitha grupet e ekspertëve, grupet e punës për çdo kapitull dhe takimet e ekipit negociator kurdo që çështjet e aderimit prekin shoqërinë civile, përmes një procesi përzgjedhjeje transparent pas një ftese publike me kritere të qarta.

9.2 Angazhimi i OSHC-ve në kryerjen e vlerësimeve të ndikimit rregullator (RIA), kur përgatiten pozicionet kombëtare negociuese dhe bëhet harmonizimi ligjor, me qëllim që të bëhet identifikimi i risqeve në kohën e duhur.

9.3 Miratimi dhe publikimi i politikave për transparencën e strukturave negociuese, procedurat dhe afatet, si edhe të paktën përmbajtjen e pozicioneve negociuese për dijeninë e publikut të gjerë.

9.4 Rritja e pjesëmarrjes së OSHC-ve në programimin e fondeve të paraanëtarësimit në BE, bazuar në parimin e partneritetit.

9.5 Sigurimi i fondeve adekuate nga BE-ja për zhvillimin e shoqërisë civile, sidomos për programet që kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve që të kryejnë monitorim efektiv të zbatimit të *acquis* të BE-së dhe kohëzgjatjes së reformave të integritetit evropian.

9.6 Mbështetja e ngritjes së fondit për bashkëfinancimin e projekteve të BE-së për OSHC-të.

9.7 Përgatitja e planit të komunikimit publik për procesin e integritetit në BE, ku specifikohet roli i shoqërisë civile në zbatimin e planit të komunikimit.

9.8 Investimi i fondeve shtesë në forcimin e rrjeteve evropiane të OSHC-ve që të forcojnë kapacitetet për pjesëmarrjen e tyre në proceset e politikave kombëtare, edhe që të mundësohen për të dhënë kontribut më thelbësor në promovimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe solidaritetit ndërmjet qytetarëve shqiptarë dhe qytetarëve të BE-së.

9.9 Forcimi i kapaciteteve të Njesisë për Shoqërinë Civile dhe Strategjinë pranë MIE-s që të luajë rol kyç në sigurimin e përfshirjes aktive të OSHC-ve në të gjitha aspektet e procesit të integritetit evropian të Shqipërisë.

9.10 Mundësimi i përfshirjes efektive të OSHC-ve në punën e Këshillit Kombëtar për Integritetin Evropian (bazuar në kritere përzgjedhjeje transparente), si mekanizëm institucional kyç për konsultimet mbi çështjet e BE-së.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Asistimi i Ministrisë së Integritetit Evropian në përgatitjen dhe zbatimin e planit të komunikimit të integritetit evropian, në partneritet me shoqërinë civile;
- Organizimi periodik i debateve publike mbi çështjet e *acquis* të BE-së, me pjesëmarrjen e qytetarëve, OSHC-ve, partnerëve socialë dhe përfaqësuesve të tjerë të shoqërisë civile të organizuar nga mbarë vendi;
- Forcimi i kapaciteteve të OSHC-ve për pjesëmarrje më aktive në çështjet e BE-së;

-Lehtësimi i komunikimit të punës së Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian të shoqëria civile.
Institucionet përgjegjëse: MIE

SHTOJCA 1

FUSHAT PRIORITARE DHE INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR ZBATIMIN E: UDHËRRËFYESIT PËR HARTIMIN E POLITIKËS DHE MASAVE PËR NJË MJEDIS MUNDËSUES PËR SHOQËRINË CIVILE

Fushat prioritare dhe institucionet përgjegjëse për zbatim		
UDH.01	Mjedisi kombëtar i politikave strategjike për zhvillimin e shoqërisë civile	Kryeministria Ministria e Integrimit European
UDH.02	Institucionet që mbështesin bashkëpunimin qeveri-OSHC	Kryeministria Ministria e Integrimit European Ministria e Financave Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
UDH.03	Përfshirja e OSHC-së në procesin e politikëbërjes	Ministria e Integrimit European Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
UDH.04	Kuadri i financimit publik për programet e OSHC-së	Ministria e Integrimit European Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile Ministria e Financave
UDH.05	Kuadri legjislativ për regjistrimin dhe punën e OSHC-së	Ministria e Integrimit European Ministria e Financave Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
UDH.06	Kontabiliteti/raportimi financiar dhe trajtimi tatimor i OSHC-së	Ministria e Financave Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
UDH.07	Mbledhja dhe disponueshmëria e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile	Ministria e Financave Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
UDH.08	Zhvillimi i vullnetarizimit	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Ministria e Integrimit European Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
UDH.09	Kontributi i OSHC-së në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë	Ministria e Integrimit European